

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 Gusht 2010), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-150 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-209 Për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10 / 03 prill 2017), si dhe nenet 54 dhe 85 të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 nëntor 2023, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR AUDITIMIN E JASHTËM TË BANKAVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është të plotësojë, ndryshojë dhe harmonizojë Rregulloren për auditimin e jashtëm të bankave, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore me datë 9 nëntor 2012 (me tutje rregullorja bazë).

Neni 2

1. Neni 4 paragrafi 5 i rregullores bazë, ndryshohet me tekstin si në vijim:
 5. Punësimi i vazhdueshëm i auditorit të jashtëm të njëjtë është i kufizuar në pesë (5) vite apo pesë (5) auditime të njëpasnjëshme, dhe mund të marrë pjesë në auditimin e të njëjtës bankë përsëri, pas kalimit të afatit kohor prej të paktën dy (2) vitesh.
2. Neni 4 të rregullores bazë, i ndryshuar me këtë rregullore, pas paragrafit 5 i shtohet paragrafi 6 si në vijim:
 6. Në rastin kur auditori i jashtëm është aktualisht i angazhuar dhe miratuar nga BQK, me rastin e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, vazhdimi i angazhimit të tij mund të bëhet ashtu që në asnjë rast nuk kalon periudhën pese (5) vjeçare nga data e angazhimit të parë.

Neni 3

Neni 8 paragrafi 2 i rregullores bazë, ndryshohet me tekstin si në vijim:

2. Auditorët e jashtëm të miratuar, gjithashtu, duhet të jenë në pajtim me dispozitat e Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim si dhe aktet e nxjerra nënligjore në zbatim të këtij ligji për çështjen e pavarësisë së auditorëve.

Neni 4
Efektet dhe hyrja në fuqi

1. Të gjitha dispozitat tjera të rregullores bazë, përveç dispozitave të ndryshuara dhe plotësuara me këtë rregullore, mbeten në fuqi.
2. Kjo Rregullore hyn në fuqi me datë 1 dhjetor 2023.
3. Kjo rregullore lexohet dhe kuptohet si një me rregulloren bazë dhe konsiderohet pjesë përbërëse e saj, bashkë me dispozitat e ndryshuara.

Bashkim Nurboja
Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës